



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE

PROJEKT VENDIM

NR. \_\_\_\_ DATË \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË QËNDRUESHËM PËR ENERGJINË  
DHE KLIMËN (SECAP) TË BASHKISË DURRËS 2030**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 106, datë 16.12.2024 "Për dhënen e miratimit Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e Konventës së Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energinë" si dhe sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 37, datë 13.01.2023 i ndryshuar, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe,

**TË VENDOSË:**

1. Miratimin e planit të veprimit të qëndrueshëm për energjinë dhe klimën (SECAP) të Bashkisë Durrës 2030, bashkëngjitur këtij projektvendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**DREJTORIA LIGJORE**

Drejtore  
Alneida Rrusthi

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Drejtore  
Ardian Hlazaj

**DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE  
INFRASTRUKTURËS**

Drejtore  
Lorenc Pacaja

**KRYETAR**  
Emriana Sako



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DURRËS

### RELACION

#### PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË QËNDRUESHËM PËR ENERGJINË DHE KLIMËN (SECAP) TË BASHKISË DURRËS 2030

Të nderuar këshilltarë,

Në përputhje me angazhimet që Bashkia Durrës ka marrë si pjesë e Konventës së Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energjinë me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 106, datë 16.12.2024 “Për dhënien e miratimit Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e Konventës së Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energinë”, është përgatitur dhe paraqitur për miratim Plani i Veprimit të Qëndrueshëm për Energjinë dhe Klimën (SECAP) për periudhën deri në vitin 2030. Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligj nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, Ju informojmë se me asistencën e GIZ-it institucioni ynë hartoi Planin e Veprimit të Qëndrueshëm për Energjinë dhe Klimën (SECAP-in).

Pas miratimit të Paketës së Bashkimit Evropian për Klimën dhe Energjinë në 2008, Komisioni Evropian lançoi Paktin e Kryetarëve të Bashkive, për të mbështetur përpjekjet e përcaktuara nga autoritetet lokale për zbatimin e politikave të qëndrueshme të energjisë që adresojnë zbutjen e klimës me anë të reduktimit të konsumit të karburanteve fosileve.

Nënshkruanit e Paktit të Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energjinë angazhohen të përgatisin dhe zbatojnë një Plan Veprimi të Qëndrueshëm për Energjinë dhe Klimën (SECAP) në të cilin përcaktohen objektivat për vitin 2030 dhe përshkruajnë veprimet që do të ndërmarrin për të reduktuar emetimet e tyre të gazeve serë dhe për t'iu përshtatur efekteve të ndryshimit të klimës.

Në këtë kuadër bashkëpunimi shprehëm interesin tonë institucional për t'iu bashkuar Konventës së Kryetarëve dhe për të hartuar planin SECAP si një mundësi pozitive për qytetin tonë në reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> në qytetin/Bashkinë Durrës, me të paktën 40% deri në vitin 2030 krasuar me vitin bazë (viti 2015).

#### A) FUSHËVEPRIMI I SECAP

SECAP përfshin një vlerësim lokal të kontekstit gjeografik, demografik dhe energetik, një Inventar Bazë të Emetimeve (BEI) që i referohet një viti bazë specifik, një përcaktim të qartë të objektivit të reduktimit të emetimeve, si dhe veprimet zbutëse të planifikuara për të arritur këtë objektiv, duke përfshirë kornizat kohore, caktimin e përgjegjësive, vlerësimin e ndikimeve dhe kostot. Përveç kësaj, Pakti i Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energjinë kërkon nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të kryejnë një vlerësim të vulnerabilitetit nga efektet e ndryshimeve klimatike në territorin e tyre dhe të identifikojnë rreziqet kryesore për njerëzit, pronën, jetesën dhe mjedisin nga i cili varen në mënyrë që të përcaktohen masat e duhura të përshtatjes dhe të kontribuojnë në përmirësimin e aftësisë përbolluese të territorit ndaj ndryshimeve.

## B) OBJEKTIVI I DOKUMENTIT SECAP

Qëllimi i SECAP është të kontribuojë në një zhvillim afatgjatë të qëndrueshëm të komuniteteve lokale dhe të mbështesë përpjekjet kombëtare të uljes së emetimeve dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në mënyrë të konkrete dhe efikase në nivelin e komuniteteve. SECAP përshkruan një sërë masash konkrete që synojnë arritjen e këtyre rezultateve dhe të ofrojnë një vizion të së ardhmes së komuniteteve lokale, i cili duhet të frysëzojë dhe ti japë formë zhvillimit të politikave lokale dhe kombëtare në të gjithë sektorët e ndryshëm kryesorë. Përveç kësaj, SECAP gjithashtu shërben për të mundësuar një klimë të qëndrueshme për investime dhe zhvillim ekonomik, gjithashtu edhe për mirëqenien dhe jetesën e komuniteteve lokale dhe qytetarët e saj, duke rritur elasticitetin dhe kapacitetet e adaptimit ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike .

Planin e Veprimit për Energjinë e Qendrueshme dhe Klimën (SECAP) i Bashkisë Durrës përcakton veprimet e zbutjes dhe të përshtatjes për energjinë dhe ndryshimet e klimës, të cilat nevojiten të ndërmerrin në nivelin e qeverisjes vendore, dhe të cilat i bashkohen veprimeve në nivelin e qeverisjes qendrore, duke kontribuar së bashku në përbushjen e objektivave kombëtare për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës deri në vitin 2030.

Ky plan ka filluar të hartohet në periudhën 2023-2024 përmes përfshirjes së një grupei të gjërë specialistësh vendore të sektorëve të ndryshëm, të ekspertëve kombëtare dhe me mbështetjen e GIZ. Plani përmban Inventarin Bazë të Emetimeve (BEI) për të përcaktuar dhe krahasuar ndikimin e aktiviteteve zbutëse dhe Vlerësimin e Riskut dhe Cenueshmërisë (RVA) të sektorëve përkatës të aktiviteteve ndaj ndryshimeve klimatike.

Në më shumë detaje, SECAP përqendrohet në masat që synojnë reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serë si dioksidi i karbonit ( $CO_2$ ), konsumi përfundimtar i energjisë nga konsumatorët fundorë, si dhe të përfshijnë veprime në lidhje me përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Angazhimet sipas paktit të kryetarëve mbulojnë të gjithë zonën gjeografike të autoritetit lokal, prandaj SECAP duhet të përfshijë veprime në lidhje me sektorin publik dhe privat. Megjithatë, autoriteti lokal pritet të luajë një rol shembullor dhe të marrë masa si model në lidhje me ndërtesa dhe objektet e veta, flotën e automjeteve etj.

### PLANI SECAP PËR BASHKINË DURRËS PËRFSHIN:

- Dekarbonizimin e territorit të bashkisë nënshkruese të CoM, duke kontribuar në mbajtjen e nivelit global të ngrohjes nën  $+2^{\circ}C$  krahasuar me temperaturat e periudhës 'para-industiale', në përputhje me Marrëveshjen e Parisit (COP 21) të vitit 2015;
- Territori i bashkisë është më rezistent ndaj ndikimeve të dëmshme të ndryshimeve klimatike;
- Qasje universale në shërbimet të qëndrueshme dhe cilësore energetike, me çmime të përballueshme, për të rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe cilësinë e jetës së qytetarëve;

Sektorët kryesorë të synuar janë:

- ▶ sektori i ndërtesa, ku janë përfshirë ndërtesa publike dhe private rezidenciale dhe biznesit,
- ▶ ndriçimi publik;
- ▶ sektori i transportit privat dhe publik urban.

Masat e planifikuara përfshijnë edhe sektorët: jo-energetik: bujqësinë, pyjet dhe përdorimet tjera të tokës; dhe menaxhimi I mbetjeve te ngurta bashkiake.

## PËRFITIMET PËR QYTETIN/BASHKINË DURRËS DHE KOMUNITETIN PËRFSHIJNË:

- Sektori i ndërtesave
  - Rinovimi i ndërtesave publike bashkiake për të përmirësuar eficiencën e energjisë
  - Instalimi i një sistem eficient të ndriçimit në ndërtesat publike bashkiake
- Sektori i transportit privat dhe publik
  - Nxjte nëpërmjet politikave fiskale e përdorimit taksive elektrike / hibride
  - Ndërtimi i një parkingu i pajisur me panele solare foto-voltaike (PV) me stacione mbushje/karikimi për makinat elektrike në zonën pranë stacionit të trenit dhe zonës së Durrësit
- Sektori bujqësisë dhe përdorime të tjera të tokës
  - Ruajtja e tokës bujqësore përmes përdorimit të synuar
  - Mbjellja e sipërfaqeve kodrinore me fidane pishash në zonat kodrinore me rrëshqitje dherash


Për këtë qëllim janë realizuar një sërë takimesh dhe dëgjesë publike me grupe të ndryshme OFJ midis grupit të punës së ngritur me Urdhër nr. 37 datë 13.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për asistencë dhe këshillim gjatë hartimit të Planit të Veprimit për Energjinë dhe Klimën e Qëndrueshme 2030” dhe përfaqësues të organizatës GIZ, për të cilën është arritur dakordësia për të hartuar planin e SECAP.

Për sa më sipër ju paraqesim bashkëlidhur për miratim Planin e Veprimit të Qëndrueshëm për Energjinë dhe Klimën (SECAP) për periudhën deri në vitin 2030.

*Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin!*

Grupi I punës I ngritur me Urdhër nr. 37 datë 13.01.2023, Urdhër nr. 232 datë 10.07.2024

Ana Hoxha



Nikoleta Rusha



Soren Dedja



Ermal Kapllani



Elvis Kthupi



Lorenc Facja



Arben Alushi



Eda Çekrezi



Sokol Popoci




Mirela Stefani



Ylvjona Boraj



Andri Cerri



Myfarete Malasi



Alketa Veseli



Olta Dedej



Anisa Larti

